



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR 2023**

**25 qershor 2024**

Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, së bashku me komisionerët, z. Maksim Shuli, znj. Erjola Sadushi dhe znj. Brunilda Tavani, prezantuan në datën 24.06.2024, për Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Raportin Vjetor të ecurisë së sektorit të energjise elektrike dhe gazit natyror dhe të veprimtarisë së ERE për vitin 2023, i cili paraqet një përshkrim të detajuar si dhe të dhëna specifike mbi ecurinë e sektorëve, duke pasqyruar në mënyrë krahasimore treguesit e këtij viti me vitet parardhës.

Z. Ahmeti renditi për Komisionin objektivat kryesore të Entit Rregullator të Energjisë:

- i. promovimin e krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë,
- ii. bashkëpunimin me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera,
- iii. krijimin e kushteve lehtësuese për futjen në rrjet të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe heqjen e barrierave që mund të pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj të tregut dhe atyre që prodhojnë nga burimet e rinovueshme,
- iv. angazhimin në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jo diskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, efikasitetin e energjisë elektrike, si dhe integritet në shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme.

Gjithashtu u informua Komisioni për punën e bërë nga ERE në kuadër të ushtrimit të detyrave në lidhje me licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në sektor, monitorimin e tregut të energjisë, hartimit të kuadrit rregullator, si dhe shqyrtimit dhe përcaktimit të tarifave dhe çmimeve në përputhje me metodologjitë respektive.

Kryetari i ERE-s, z. Ahmeti referoi gjithashtu mbi të dhënat e prodhimi të energjisë elektrike, ku kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 Dhjetor 2023 është rreth 2,675 MW, me një nivel rritje nga viti 2022 prej rreth 26 MW.

Ai foli gjithashtu për centralet e prodhimit të energjisë elektrike të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike (2,288 MW) ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes (382 MW),

Po ashtu u informua Komisioni edhe mbi gjetjet që rezultojnë nga krahasimi i të dhënave historike nga të cilat vërehet se:

- prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023, në sasinë prej 8,796 GWh rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2023, çka bën që viti 2023, të konsiderohet një vit i mirë hidrik nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike, me një rritje prej 2,026 GWh mbi prodhimin mesatar të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2023.

- nivelit të arkëtimeve dhe humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit, dhe në sistemin e shpërndarjes; të cilat gjithashtu kanë shënuar përmirësim dhe janë në përputhje me targetin e miratuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2023 arrijnë në 18.93%, duke shënuar kështu ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2022. Niveli total i arkëtimeve i raportuar është 99.4 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar. Ky nivel arkëtimesh për vitin 2023 rezulton me rritje, krahasuar me nivelin e arkëtimeve të realizuara për vitin 2022.

- konsumi total i energjisë elektrike të realizuar për vitin 2023 prej 7,875,861 MWh, i cili është më i ulët se ai i vitit 2021, që është konsumi maksimal i arritur.

Po ashtu në raportimin për Komisionin, z.Ahmeti informoi edhe për funksionimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), e cila filloi operimin në orën 00:00 të datës 12.04.2023, si dhe regjistrimin e ERE në Shoqatën Europiane të lëshimit të garancive të origjinës si pjesë të objektivave të vendosur në Rezolutën e Vitit 2023.

Për sa i përket sektorit të Gazit Natyror, në Raport është pasqyruar ecuria e furnizimit me gaz në

botë dhe pozicioni strategjik i vendit tonë, konsumi i gazit dhe trendi i përdorimit të tij në vendet e BE ku vihet re një rënie e konsumit të gazit.

Bordi ju përgjigj pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, mbi çështje të tilla si, prodhuesit me përparësi, klientëve në nevojë, diversifikimit të burimeve energjitike, pyetje rreth trajtimit të ankesave ndaj FSHU sh.a. apo situatës së sektorit të gazit natyror, me qëllim sqarimin, por duke qëndruar gjithmonë brenda kompetencave të institucionit.

Për sa kërkuar gjatë diskutimeve në Komision, Kryetari informoi edhe mbi ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike gjatë ditës së premte date 21 qershor 2024, mbi procedurat që ndiqen për qëllime të hetimit të këtij incidenti të ndodhur në disa shtete të rajonit. Hetimi për këtë incident do të zhvillohet nga një organizëm i pavaruar, përkatësisht Komiteti i Operacioneve të Sistemeve i Entso- E.

Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Energjisë për Vitin 2023 do të prezantohet gjithashtu dhe në Kuvendin e Shqipërisë në seancën plenare në vijim.

Kopje e këtij raporti gjendet e publikuar në faqen e internetit të ERE në linkun e mëposhtëm:

<https://www.ere.gov.al/sq/publikime/raporte-vjetore> .